

2021

**Përmbledhje Jo-Teknike “SOLE
2000” shpk, GOSTIME-SHTERMEN-
ELBASAN**

Zhvilluesi: “SOLE 2000” Shpk

Projekti: "Furnizim me karburant dhe GLN i makinave në një stacion të furnizimit me karburant në zonat urbane"

Shoqëria:

SOLE 2000 sh.p.k

**Përgatitur
nga:**



Korrik, 2021

Përmbajtje

1. HYRJE.....	0
2. KUSHTET EKZISTUESE.....	0
3. PËRSHKRIM I SHKURTER I AKTIVITETIT	1
4. TRANSPORTI I BRENDSEHEM DHE NDERLIDHJA	2
5. PËRSHKIRMI I INSTALIMIT	3
6. IDENTIFIKIMI I NDIKIMEVE NË MJEDIS.....	4
7. TEKNIKAT MË TË MIRA TË DISPONUESHME	6
8. MBROJTJA E OBJEKTIT-MASAT NDAJ ZJARRIT	6

1. HYRJE

Shoqëria “Sole 2000” sh.p.k synon zhvillimin e aplikimit për leje mjedisi të tipit B.

Referuar Ligjit Nr. 10440, datë 07.07.2011 “Për vlerësimin e Ndikimit në Mjedis” i ndryshuar dhe fakti që objekti ku kërkohet të zhvillohet aktiviteti është ekzistues dhe bazuar në Ligjin Nr. 10448, datë 14.07.2011 “Për lejet e mjedisit”, i ndryshuar, operatori “Sole 2000” sh.p.k do të aplikojë pranë QKB-së për pajisjen me leje mjedisore me kodin:

- Industrite energjitike, ID 1.10, “Furnizim me karburant i makinave në një stacion të furnizimit me karburant në zonat urbane”

2. KUSHTET EKZISTUESE

Shoqëria “Sole 2000” shpk është një shoqëri tregtare e krijuar si person juridik me numer unik identifikimi të subjektit **K32803214P**, kryesisht në aktivitet:

- Tregtim me pakice të karburantit për automjete.

Në kuadër të këtij aktiviteti Shoqëria “SOLE 2000” SHPK kryen aktivitetin e tregtimit të karburantit me pakice për automjete.

Vendndodhja e pikes së karburantit me aktivitet: Veprimtarinë “ID, 1.10, Furnizim me karburant i makinave në një stacion të furnizimit me karburant në zonat urbane” i cili ndodhet në adresën Elbasan, Gostime, GOSTIME, Shtermen me certifikate pronësie me numer pasurie 164/54/2 dhe zone kadastrale nr.3422.

3. PËRSHKRIM I SHKURTER I AKTIVITETIT

Skema e perpunimit teknologjik të pikes së furnizimit me pakice të karburanteve është zgjedhur duke shfrytëzuar të dhënat e shoqërisë "Sole 2000". Në objektin e zhvillimit të aktivitetit referuar vertetimit teknik shoqëria ka kapacitet depozitues prej 54000 litra karburante dhe 6750 litra GLN.

Kapacitetet përmendur më lartë janë vertetuar referuar Vertetimit të Kalibrimit leshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë ku përcakton rezervuarët e karburanteve si vijojnë:

- Rezervuar nentokesor me volum 20000 litra;
- Rezervuar nentokesor me volum 20000 litra;
- Rezervuar nentokesor me volum 7000 litra;
- Rezervuar nentokesor me volum 7000 litra.


Kapaciteti depozitues i GLN vertetohet me e Miratimin e Projektit Teknologjik ku pasqyrohet kapaciteti depozitues i GLN-se prej 6750 Litra.

Aktiviteti që synohet të zhvillohet është i pajisur me vërtetim teknik gjithashtu me nr. Serial VT1674 date 03.08.2020, miratim projekti me Nr. Serial 0000074 date 03.07.2017 dhe vertetim për matjen e vëllimit të rezervuarëve me Nr. 2475/1 Prot., date 22.04.2016.

Ne vijim është pasqyruar material fotografik i aktivitetit.



Në vijim është pasqyruar planimetria e objektit dhe aktivitetit:



4. TRANSPORTI I BRENDSEM DHE NDERLIDHJA

Kompozimi i objektit është bërë duke konsideruar fillimisht skemën e lidhjes teknologjike të aparaturave në pikën e furnizimit me karburant, si dhe mundësitë e dhëna nga sheshi i parashikuar.

Mbi këto synime është realizuar shtrija në plan dhe në lartësi të objektit.

Elementët përbërës të objektit janë:

Nr.	Përshkrimi
1	Tetoja e karburantit
2	Depozitat e karburantit
3	Depozita e autogazit (GLN)
4	Distributor Karburanti
5	Distributor GLN
6	Ambjentet e shërbimit

7	Rezervuare uji (10 m ³)
8	Tende për rezervuaret

Per vete karakterin teknologjik te ketij lloji dhe rrezikshmerine qe paraqesin ato, eshte parashikuar edhe mbrojtja e pajisjeve nga renia nen presion nëpërmjet certifikatës së konformitetit të vërtetimit të përputhshmërisë së projektit teknik të pajisjes/instalimit nën presion.

5. PËRSHKIRMI I INSTALIMIT

Projekti parashikon vendosjen e rezervuareve për karburant si dhe rezervuarit për GLN sipas kapaciteteve përshkruar me sipër. Mbeshtetëset e rezervuareve janë prej betoni të armuar dhe rezervuaret e karburantit janë të fiksuara pas mbeshtetësve të betonit me një shufër çeliku me qëllim që të mos pluskojnë. Rezervuaret janë të pajisur me bakaportë në të cilën vendosen tubi i thithjes, tubi i furnizimit, tubi i ajrimit dhe tubi i matjes së nivelit. Rezervuaret, pompat dhe distributore të janë të tokëzuar.

Vendosja e objekteve që përbejnë stacionin e shitjes së karburantit dhe autogazit, është bërë e tillë që të respektojë distancat limit midis objekteve brenda stacionit, objekteve dhe infrastruktures rrethuese.

Gjithashtu janë respektuar të gjitha normat për qarkullimin e lirë të mjeteve dhe personelit të punës mbeshtetur në kushtet teknike dhe normat e projektimit për impiantet dhe instalimet që shërbejnë për transport depozitim dhe tregtim të naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre.

- Autogazi nëntokesor

Autogazi nëntokesor është parashikuar të vendoset i vecuar dhe mbi një bazament betoni. Depozita e gazit është e pajisur me të gjithë aksesoret e nevojshëm si me valvulë të mbushjes, valvulën e shkarkimit, valvulën me dy veprime, valvulën e sigurisë, nivel matës etj. Trupi i depozitës tokëzohet për të mbrojtur nga elektriciteti statik.

- Depozitat e karburantit

Depozitat e karburantit me kapacitetet përkatëse përshkruar me sipër, janë projektuar nëntokesore, të përgatitura prej llamarinë çeliku, cilindrike dhe të vendosura brenda një kosntruksioni beton armë.

Cdo depozitë ka bakaportë nëpërmjet kapakut të së cilës dalin linjat e tubacioneve hyrje-dalje të karburantit, për shkarkimin e avujve, për matjen e nivelit dhe për marrjen e kampionit. Linjat janë të pajisura me flakëpenguese.

- Pompat

Pompat janë të pa levizshme dhe të montuara poshtë tendes, në bazament prej betoni. Çdo pompe është e kompletuar sipas normës, e fiksuar mirë në dysheme dhe e mbyllur me veshje metalike. Elektromotori dhe linjat elektrike të tyre janë të tipit të mbyllur dhe hermetike. Sipas llojit të karburantit edhe elektromotoret janë të ndara në elektomotore naftë dhe elektromotore benzite.

- Tenda e stacionit të shitjes së karburantit

Tenda e stacionit të shitjes së karburantit, është e ndërtuar prej materialeve të pa djegshme dhe e ngritur mbi materiale metalike.

- Ndertesa e pikes

Ambjentet e shërbimit janë vendosur në ndertesën e ndërtuar (pra ekzistuese) në një pozicion midis platformës së pompave dhe sheshit të depozitave të karburanteve.

- Vendi i parkimit të automjeteve

Është parashikuar në shesh të hapur brenda rrethimit. Sheshi i parkimit ndodhet në kufizin fundor të pronës në anën jugore të pikes së karburantit. Parkimi i automjeteve do të jetë i perkohshëm dhe numri i tyre i kufizuar.

6. IDENTIFIKIMI I NDIKIMEVE NË MJEDIS

Airi

Aktiviteti i subjektit është vetëm furnizimi me pakice për automjete me karburant dhe për këtë arsye nuk ka shkarkim të ndotësve në ajër. Ndotja në ajër konsiderohet e papërfillshme, tepër minimale dhe e kufizuar në kohë pasi sistemi i instalimit dhe teknologjia e përzgjedhur minimizon në maksimum emetimin e aromave dhe rrjedhjet e gazeve në atmosferë.

Ujërat

Në përgjithësi nga vetë natyra e aktivitetit të subjektit nuk ka shkarkime ujore apo ndotje pasi aktiviteti është i kufizuar. Në rast derdhesh aksidentale të hidrokarbureve në sipërfaqe, përsëri nuk parashikohet ndotje pasi sipërfaqja është e shtruar me beton dhe si rrjedhojë është i pamundur infiltrimi i hidrokarbureve në ujërat nëntokësore. Ndotja e ujit konsiderohet e papërfillshme.

Zhurmat

Aktiviteti I punes është I tille qe nuk ka burime fikse te zhurmes, duke qene se procesi I punes perfshin vetem furnizimin. Gjithsesi si impakt zhurma mund te vije nga levizja e mjeteve.

Flora dhe fauna

Nuk parashikohen ndikime ne bimësi duke përmendur lloje endemike, lloje me status të veçantë, habitate me vlera, ekosisteme funksionale etj. Zona nuk ka vlera të veçanta floristike, megjithatë zona e subjektit për ushtrimin e aktivitetit është e kufizuar në një sipërfaqe jo të madhe. Gjithashtu edhe për faunën e zonës, lidhur me specie me status të veçantë dhe të mbrojtura, theksohet se specie të tilla nuk janë prezente në zonën e aktivitetit. Përreth zonës mund të hasen vetëm shpende të qytetit.

Ndotja e tokës

Zhvillimi i aktivitetit te synuar nuk shkakton shkarkime ne toke dhe si rrjedhim nuk ndikon ne cilesine e tokes apo shkakton ndotje te saj. Mbetjet e gjeneruara gjate ditës së punës grumbullohen në koshat përkatës nga punonjësit e karburantit dhe më pas largohen për ne vendndodhjen e grumbullimit të mbetjeve nga njesia lokale. Nuk parashikohen ndikime negative në tokë nga ushtrimi i aktivitetit.

Rastet aksidentale

Zbatimi i aktivitetit të subjektit vlerësohet se nuk do të sjell rrezikshmëri për aksidente. Sheshi i ndertimit te pikes, aksesoret dhe pajisjet jane dhe funksionojne sipas kerkesave te sigurise se Pajisjeve nen Presion. Largesia e ishullit te pompave nga buza e rruges eshte afersisht 15 m. Në rast zjarri automjetet zjarrfikëse mund të afrohen dhe të veprojnë për shuarjen e tij pa pengesë dhe në mënyrë efektive direkt nga rruga kryesore Cerrik-Gostime. Objekti plotëson të gjitha kërkesat teknike dhe urbanistike për të kryer një aktivitet të tillë. Janë marr masat për parandalimin e rasteve aksidentale, mjetet kontrollohen vazhdimisht për gjendjen teknike të tyre në mënyrë që të mos kemi rrjedhje lubrifikanti apo karburant. Shoqëria siguron se do ketë ndërhyrje të menjëhershme nëse do të ketë ndikime negative ne mjedis.

Burimet e shkarkimeve nga instalimi

Nga aktiviteti i furnizimit me karburant nuk ka burime emetimi, pasi nafta ne territorin e karburantit, vjen e mbyllur dhe e izoluar. Parashikohet qe gjate transportit te cisternes me naftë, nga makinerite e transportit te kete emetime te lehta (pluhura, gaze), si dhe gjenerim te vogel te zhurmave.

7. TEKNIKAT MË TË MIRA TË DISPONUESHME

- Shoqeria Sole 2000 Shpk, zbaton teknikat më të mira të disponueshme për të minimizuar ndotjet. Duke patur parasysh aktivitetin e shoqërisë, përmendim këtu: kontrollin periodik dhe inspektimin për incidente të mundshme gjatë transportit apo magazinimit të naftës, spërkatjen me ujë të territorit përreth cisternës në kohë të thate, uljen e shpejtësisë së makinerive, trajnimin e punonjësve etj.
- Marrjen e menjëhershme të masave në rast ndotjesh (incidente me derdhjet e karburanteve, vajrat nga makineritë) si dhe monitorim të vazhdueshëm.
- Në përputhje me ligjin mbi menaxhimin e intergruar të mbetjeve, shoqëria ka parim minimizimin e mbetjeve, ripërdorimin dhe në fund asgjësimin e tyre.
- Shoqëria ka marrë masa për të përdorimit eficient: fikja e makinerive/pajisjeve kur nuk është e nevojshme që të punojnë, shfrytëzimi i dritës natyrore.
- Subjekti synon kontrollin dhe mirëmbajtjen periodike të makinerive, duke minimizuar kështu avaritë dhe ndotjet që mund të vijnë si pasojë. Gjithashtu subjekti do të pajisë ambientet me kutinë përthithëse (spill-kit) në rast incidenti për të përdorimit të makinerive me karburant si dhe ka bërë trajnimin e duhur të punonjësve në lidhje me nderhyrjen dhe përdorimin e kutisë së incidenteve.
- Paralelisht me funksionimin, subjekti gjithashtu do të kujdeset dhe për rehabilitimin e mjedisit, në mënyrë që të minimizohet impakti negativ fillestar në peisazh. Subjekti mer përparësi sigurimin e ecurisë normale të punës dhe ruajtjen e vazhdueshme të mjedisit deri në mbylljen e aktivitetit.

8. MBROJTJA E OBJEKTIT-MASAT NDAJ ZJARRIT

Për vetë karakteristikat e punës së objektit do të përdoren lëndë lehtësisht të ndezshme. Janë parashikuar dhe janë marrë një sërë masash teknike dhe administrative për të siguruar mbrojtjen dhe sigurinë e punës në objekt sikurse është hartuar edhe projekti i mbrojtjes nga zjarri. Gjithashtu objekti është pajisur me Certifikatë MNZ nga Bashkia e Cërrik, Sektori I shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi, me Nr.30Prot., datë 11.05.2020.

Objekti disponon mjete të mbrojtjes nga zjarri të cilat janë në gatishmëri të plote për raste të mundshme emergjence. Gjithashtu objekti disponon hydrant të vendosur në ambientet e karburantit.

Tabelat e evakuimit të punonjesve dhe qytetareve në raste emergjencash janë të afishuara në objekt. Distanca hyrje-dalje në objekt janë respektuar dhe në brendësi ka shesh të mjaftueshëm për manovrimin e automjeteve.

Zbatimi i aktivitetit të subjektit vlerësohet se nuk do të sjell rrezikshmëri për aksidente. Sheshi i ndertimit të pikes, aksesoret dhe pajisjet janë dhe funksionojnë sipas kërkesave të sigurisë së Pajisjeve në Presion. Largesia e ishullit të pompave nga buza e rruges është afërsisht 15 m. Në rast zjarri automjetet zjarrfikëse mund të afrohen dhe të veprojnë për shuarjen e tij pa pengesë dhe në mënyrë efektive direkt nga rruga kryesore Cerrik-Gostime.

Për vendosjen e depozitave plotësohen të gjitha kërkesat teknike të rregullores së instalimit të pajisjeve të gazit.

Gazi i lëngshëm i naftës nuk përbën impakt për ambientin dhe ekosistemin. Megjithatë për vetë kushtet e punës së tij si lëng nën presion, aparatat dhe pajisjet janë të tilla që nuk lejojnë asnjë rrjedhje. Përveç kësaj rezervuarve u janë vendosur valvula fluksi dhe kundervalvula në të gjitha konjeksionet e tij, me qëllim bllokimin e menjëhershëm të rezervuarit për çdo rast të konstatimit të rrjedhjeve në tubacione dhe pajisje.

Pajisjet që shërbejnë në përdorimin e GLN, si dhe materialet që përdoren paraqesin një sërë rreziqesh për personelin që punon. Këto rreziqe do të njihen dhe të kontrollohen me qëllim që të bëhen të padëmshme, në një nivel të pranueshëm, të përcaktuar nga rregullorja e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes në punë.